

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET
PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AKEP-in si autoritet i pavarur në mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke theksuar rëndësinë e një bashkëpunimi ndërinstitucional të strukturave përgjegjëse për implementimin sa më parë të numrit 112 të emergjencave si një kërkesë e përsëritur edhe në rekomandimet e raportprogresit të KE-së;

Duke theksuar rëndësinë e rritjes dhe përmirësimit të sigurisë kibernetike, mbikëqyrjen rregullatore të qëndrueshmërisë, pacenueshmërisë dhe integritetit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në vend;

Duke theksuar se nxitja e investimeve duhet të ketë në fokus zhvillimin e qëndrueshëm digjital të vendit, rritjen e cilësisë së shërbimit, garantimin e të drejtave të konsumatorëve, si dhe nxitjen e konkurrencës së ndershme dhe të lirë në treg;

Shqyrtoi veprimtarinë e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2025 dhe vlerëson:

Gjatë vitit 2025 të ardhurat e shërbimeve celulare u rritën me rreth 4%, duke reflektuar një dinamizëm të vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve dhe rritjen e kërkesës për shërbime *broadband* dhe të dhëna celulare.

Punën e bërë në realizimin e analizës së tregut të shërbimeve postare dhe lëshimin e autorizimit të ri individual për subjektin “Posta Shqiptare” sh.a. për Shërbimin Universal në këtë treg. Autorizimi i ri përmban detyrime të qarta për modernizimin e rrjetit, rritjen e cilësisë së shpërndarjes dhe mbajtjen e tarifave në nivele të përballueshme, duke synuar formalizmin e mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjen e përdoruesve.

Punën e bërë për rregulloren e re të portabilitetit të numrit, bazuar edhe në përcaktimet e reja ligjore të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Rregullorja e re është miratuar tashmë me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 2, datë 2.2.2026.

Punën e bërë për miratimin e ndryshimeve rregullatore, të cilat përcaktojnë masat teknike dhe organizative, si dhe politikat që duhet të ndërmerren nga sipërmarrësit në kuadër të garantimit të sigurisë dhe integritetit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Punën e bërë për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), e cila përmes forcimit të bashkëpunimit institucional, si dhe shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit të veprimeve synon rritjen e efikasitetit dhe përmbushjen e objektivave të përbashkët në fushat e kompetencës së dy institucioneve.

Punën e bërë nga AKEP-i, si dhe takimet e organizuara me ofruesit e shërbimeve dhe institucionet përkatëse në funksion të transparencës institucionale, por edhe të nevojës për marrjen e mendimeve, propozimeve dhe komenteve të grupeve të interesit për hartimin e kuadrit nënligjor.

Kuvendi i Shqipërisë rekomandon që Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2026, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të bashkëpunojë ngushtë dhe të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për Autoritetin e Konkurrencës, në kuadër të procesit të hetimit të filluar nga Autoriteti i Konkurrencës në tregun e ofrimit të shërbimeve celulare me pakicë për të bërë të mundur një vlerësim sa më të drejtë të shqetësimeve të konsumatorëve në tregun e ofrimit të shërbimeve mobile me pakicë, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit konsumator dhe nxitjes së konkurrencës efektive në treg.

2. Të rrisë përpjekjet institucionale duke bërë të mundur që përmes politikave rregullatore, nga njëra anë, të përmirësojë dhe të nxisë konkurrencën efektive në tregun e komunikimeve elektronike dhe mobile dhe, nga ana tjetër, të krijojë lehtësitë e nevojshme për futjen në treg të MVNO-ve,

prezenca e të cilave do të ishte një faktor i rëndësishëm në nxitjen, rritjen e konkurrencës dhe shmangien e një tregu duopol.

3. Të vijojë të ndjekë me përparësi zbatimin e planit të veprimit për sistemimin e kabllave ajrore, duke bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet qendrore, bashkitë e vendit, OSSH-në dhe operatorët e tregut të komunikimeve elektronike. Të nxisë bashkëpërdorimin e infrastrukturës, me qëllim reduktimin e kostove të ndërtimit dhe shmangien e mbivendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike. Të angazhohet në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve të përfshira në këtë proces.

4. Të vijojë në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) dhe institucionet e tjera përgjegjëse ndjekjen me prioritet të procesit të lirimit të brezit Digjital Dividend II (DD2), me qëllim vënien në dispozicion të brezit 700 MHz për zhvillimin e rrjeteve 5G dhe zgjerimin e mbulimit me shërbime të komunikimeve elektronike me brez të gjerë në të gjithë territorin e vendit.

5. Të vijojë ndërmarrjen e masave rregullatore për nxitjen e investimeve në rrjetet me kapacitet shumë të lartë, përfshirë rrjetet 5G, forcimin e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike, në përputhje me ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe praktikën më të mira të Bashkimit Evropian.

6. Pas lëshimit të autorizimit të ri individual për subjektin “Posta Shqiptare” sh.a. për Shërbimin Universal, të ndjekë dhe të monitorojë detyrimet e përcaktuara në autorizim për modernizimin e rrjetit, rritjen e cilësisë së shpërndarjes dhe mbajtjen e tarifave në nivele të përballueshme, që synojnë formalizmin e mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjen e përdoruesve.

7. Në bashkëpunim me strukturat tatimore dhe në funksion të një konkurrence të ndershme në fushën e shërbimeve postare, të vijojë monitorimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këtë fushë, në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, duke identifikuar rastet e shkeljeve dhe duke marrë masat përkatëse konform legjislacionit në fuqi.

8. Pas miratimit të rregullores së re të portabilitetit të numrit, AKEP-i të monitorojë me rigorozitet zbatimin e ndryshimeve të bëra në rregullore nga ana e dy operatorëve, në mënyrë që procesi i portimit të numrit të jetë një proces i thjeshtë, efektiv dhe mbrojtës i drejtat e përdoruesve fundorë.

9. Në kuadër të garantimit të ruajtjes së integritetit dhe sigurisë së rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, duke u bazuar në ndryshimet e reja rregullatore, të cilat përcaktojnë masat teknike dhe organizative që duhet të marrin këta sipërmarrës, si dhe politikën që ata duhet të ndjekin, AKEP-i të kryejë auditime dhe inspektime të vazhdueshme për zbatimin e këtyre masave dhe ndryshimeve nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

10. Të vijojë hartimin, miratimin dhe përditësimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim garantimin e zbatimit të plotë dhe efektiv të kuadrit të ri ligjor, në përputhje me *acquis*-n e Bashkimit Evropian dhe zhvillimet teknologjike të sektorit.

11. Të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe me aktorë të tjerë për ndryshimet e nevojshme ligjore, të cilat mundësojnë harmonizim të plotë të legjislacionit të Shqipërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian, për të bërë të mundur fillimin e RLAH (*Roaming Like At Home*) midis dy palëve, si një proces i cili do të sillte përfitime për lëvizjen e lirë të qytetarëve, do të përmirësonte klimën e biznesit midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të Bashkimit Evropian dhe do të ishte një hap i rëndësishëm drejt integritetit në tregun unik digjital të BE-së.

12. Të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis*-n e BE-së, si dhe masave të parashikuara në Agjendën e Reformave për transpozimin e Aktit të Shërbimeve Digjitale (DSA) dhe Aktit të Infrastrukturës Gigabit (GiA) në legjislacionin shqiptar.

13. Duke iu referuar praktikave më të mira evropiane, të vlerësojë mundësinë e krijimit të një platforme publike për krahasimin e tarifave dhe cilësisë (e cila krahason tarifat mobile dhe fikse; përfshin cilësinë e shërbimit; mundëson krahasim të internetit mobil, SMS etj.), me qëllim rritjen e transparencës së tregut, fuqizimin e konsumatorit dhe nxitjen e konkurrencës mes operatorëve.

14. Pas monitorimeve të kryera dhe evidentimit të zonave/akseve rrugore ku ka mangësi në mbulim ose cilësi shërbimi dhe pas kërkesave drejtuar operatorëve për marrjen e masave për optimizimin e konfigurimit të antenave ekzistuese, rritjen e kapaciteteve të rrjetit apo edhe vendosjen

e stacioneve provizore të transmetimit për të përballuar ngarkesën e shtuar të trafikut, të ndjekë me rigorozitet plotësimin dhe zbatimin e kërkesave që rregullatori u ka drejtuar operatorëve.

15. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës të Kuvendit, në funksion të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3-mujorit të tretë të këtij viti.

16. Të forcojë dhe të institucionalizojë bashkëpunimin ndërinstitucional me Autoritetin e Mediave Audiovizive, Prokurorinë e Përgjithshme, Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e të Drejtës së Autorit dhe Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut përmes nënshkrimit të një memorandumi bashkëpunimi, me qëllim rritjen e koordinimit për parandalimin dhe luftën kundër piraterisë digjitale, mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe forcimin e sigurisë në hapësirën digjitale. Brenda 30 ditëve nga miratimi i kësaj rezolute, të informojë Kuvendin për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi.

17. Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit të turizmit në ekonominë e vendit, të punojë për nënshkrimin e një memorandumi bashkëpunimi me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për të bërë të mundur krijimin e një baze të dhënash/inventari të mbulimit me shërbimin internet të njësive akomoduese dhe atraksioneve turistike në vend dhe në të njëjtën kohë vlerësimin e mundësive për ofrimin e këtij shërbimi në këto zona.

Miratuar në datën 16.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi